



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

## RAPORT

### I

## AVOKATIT TË POPULLIT

**Ex officio nr. 563/2024**

*lidhur me detyrimet pozitive për ndërmarrjen e masave preventive në Qendrat për Punë Sociale për mbrojtjen e integritetit fizik, gjegjësisht të së drejtës për jetë, si e drejtë absolute*

### Drejtuar:

Z. Agim Aliu - kryetar i Komunës së Ferizajt  
Z. Shpejtim Bulliqi - kryetar i Komunës së Podujevës  
Z. Xhafer Gashi - kryetar i Komunës së Obiliqit  
Z. Ramiz Lladrovci - kryetar i Komunës së Drenasit  
Z. Imri Ahmeti - kryetar i Komunës së Lipjanit  
Znj. Liljana Shubariq - kryetare e Komunës së Graçanicës  
Z. Besim Ilazi - kryetar i Komunës së Kaçanikut  
Z. Alban Hyseni - kryetar i Komunës së Gjilanit  
Z. Kadri Rahimaj - kryetar i Komunës së Kamenicës  
Z. Vladan Bogdanoviq - kryetar i Komunës së Klllokotit  
Znj. Katarina Ristiq - kryetare e Komunës së Ranillukut  
Z. Dragan Petkoviq - kryetar i Komunës së Parteshit  
Z. Bedri Hamza - kryetar i Komunës së Mitrovicës Jugore  
Z. Fadil Nura - kryetar i Komunës së Skenderajt  
Z. Ferit Idrizi - kryetar i Komunës së Vushtrrisë  
Z. Shaqir Totaj - kryetar i Komunës së Prizrenit  
Z. Ardian Gjini - kryetar i Komunës së Gjakovës  
Z. Gazmend Muhaxheri - kryetar i Komunës së Pejës  
Z. Erden Atiq - kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore  
Z. Lulzim Hetemi - kryetar i Komunës së Leposaviqit  
Z. Izmir Zeqiri - kryetar i Komunës së Zubin Potokut

Z. Ilir Peci - kryetar i Komunës së Zveçanit  
Z. Burim Berisha - kryetar i Komunës së Fushë Kosovës  
Z. Qemajl Aliu - kryetar i Komunës së Shtimes  
Z. Mehmet Ballazhi - kryetar i Komunës së Hanit të Elezit  
Z. Sokol Halili - kryetar i Komunës së Vitisë  
Z. Sasha Miloseviq - kryetar i Komunës së Novobërdës  
Z. Bali Muharremaj - kryetar i Komunës së Suharekës  
Z. Abdulhadi Krasniç - kryetar i Komunës së Mamushës  
Z. Bexhet Xheladini - kryetar i Komunës së Dragashit  
Z. Smajl Latifi - kryetar i Komunës së Rahovecit  
Z. Ekrem Kastrati - kryetar i Komunës së Malishevës  
Z. Ilir Ferati - kryetar i Komunës së Istogut  
Z. Ruzhdi Shehu - kryetar i Komunës së Junikut  
Z. Zenun Elezaj - kryetar i Komunës së Klinës  
Z. Bashkim Ramosaj - kryetar i Komunës së Deçanit  
Z. Dalibor Jevtiq - kryetar i Komunës së Shtërpçës

Prishtinë, më 17 prill 2025

## Qëllimi i raportit

1. Ky raport u iniciua sipas detyrës zyrtare bazuar në raportimet e “Kallxo.com”<sup>1</sup>, të datës 12 prill 2024, me titullin: “*Vrasja e 21 vjeçares në Qendrën për Punë Sociale në Ferizaj, çka dihet deri tash?*”. Në këtë drejtim u raportua se më 12 prill 2024, në Qendrën për Punë Sociale ( QPS) bëhej fjalë për vrasje dhe theksohej se viktimat dhe dorasi kanë qenë bashkëshortë faktikë dhe nga kjo bashkësi martesore kanë pasur një fëmijë.
2. Raporti ka për qëllim të vlerësojë përmbushjen e detyrimeve pozitive nga ana e autoriteteve përgjegjëse për të mbrojtur të drejtën në jetë të qytetarëve; t’i analizojë veprimet dhe mosveprimet e autoriteteve, gjegjësisht ndërmarrjen e masave preventive (pajisja me detektorë dhe staf të rojës fizike) në QPS, si parakushte të sigurisë të integritetit fizik dhe sigurisë së jetës së Zyrtarëve të Shërbimeve Sociale (ZShS) si dhe palëve që marrin shërbime në këtë institucion. Krejt këto me qëllim të zbatimit të dispozitave kushtetuese, të instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të praktikës së Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), të ligjeve, të politikave dhe strategjisë kundër dhunës në familje, të së drejtës në jetë, që janë të garantuara në shoqërinë tonë demokratike.

## Kompetenca e Avokatit të Popullit

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta)<sup>2</sup>, në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*” Kurse në paragrafin 3 përcakton: “*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.*”
4. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - “*Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).
  - “*Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
  - “*T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
  - “*Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
  - “*Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi*

<sup>1</sup> <https://kallxo.com/lajm/vrasja-e-21-vjecares-ne-ferizaj-detaje-nga-vendi-i-ngjarjes/>

<sup>2</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

*çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).*

- *“T’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).*

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet kompetente si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i realizojë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

### **Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit**

5. Më 12 prill 2024, Kallxo.com dhe mediat e tjera raportuan se në ndërtesën e QPS-së në Ferizaj është vrarë me armë zjarri E. C. dhe u plagos vëllai i saj i mitur (D. C). Në këtë drejtim, mediat raportuan se dyshohej për vrasje dhe plagosje dhe precizuan se viktimat dhe dorasi ishin bashkëshortë faktikë dhe se nga kjo bashkësi martesore kanë një fëmijë, për të cilin kujdesej tashmë e ndjera, e cila së bashku me djalin jetonte në shtëpi të prindërit e saj. Më 12 prill 2024, ajo solli fëmijën në QPS për kontakt me babanë e tij, me të cilin tashmë jetonin të ndarë dhe kishin filluar procedurën e shkurorëzimit.
6. Si reagim shoqëror i kësaj ngjarjeje u raportua nga disa rrjete lokale dhe qendrore organizimi i një proteste për manifestime të ndryshme të Rrjetit të Grave të Kosovës,<sup>3</sup> nën moton: *“Drejtësi për gratë e vrara”*, duke shkruar se dhuna ndaj E. C. u neglizhua nga institucionet e drejtësisë në vend.<sup>4</sup> Marshi protestues i Kolektivit për Mendim dhe Veprim Feminist vazhdoi nga Sheshi “Zahir Pajaziti”, te Ministria e Drejtësisë, stacioni policor dhe përfundoi para objektit të Qeverisë së Kosovës. Protestë pas vrasjes së E. C. pati edhe në Ferizaj.
7. Më 12 prill 2024, Prokuroria Themelore në Ferizaj (PThF) - Departamenti për Krime të Rënda (DKR) informoi se i dyshuari në këtë rast, me inicialet V. A., me vendim të Prokurorit të Shtetit u ndalua në kohëzgjatje prej 48-orësh, për shkak të dyshimit se kreu veprën penale “Vrasja”, sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Hetuesit rajonale të Policisë së Kosovës në Ferizaj, në koordinim me Prokurorin e Shtetit, dolën në vendin e ngjarjes dhe nga ekipi mjekësor u konstatua vdekja e viktimës dhe për të dyshuarin, brenda afatit ligjor, PThF-ja do të parashtrijë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit për veprën penale të lartcekur.
8. Më 13 prill 2024, PThF-DKR-ja njoftoi opinionin publik se kërkoi nga Gjykata Themelore në Ferizaj (GjThF) caktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh ndaj të dyshuarit me iniciale V. A., lidhur me rastin e vrasjes së rëndë në Ferizaj. Sipas Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se më 12 prill 2024, rreth orës 14:40, brenda zyrës së QPS-së në rrugën “Vëllezërit Gërvalla”, në Ferizaj, i pandehuri, me dashje ka privuar nga jeta të ndjerën E.C., me të cilën ka bashkëjetuar, duke e goditur me armë disa herë në kokë dhe ka plagosur në krah vëllain e së ndjerës (i mitur), me çka kreu veprën penale “Vrasje e rëndë”, nga neni 173, paragrafi 1, nënparagrafët 1.3, 1.5 dhe 1.11 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

---

<sup>3</sup><https://teve1.info/marsh-protestues-per-vrasjen-e-erona-coklit/>

9. Më 8 korrik 2024, zyrtari për Informim i GjThF-së e njoftoi përfaqësuesin e Avokatit të Popullit se zyrtari i çështjeve penale do ta njoftonte atë mbi numrin e lëndës, si dhe për gjyqtarin e procedurës paraprake, i cili u ngarkua me këtë lëndë.
10. Më 9 korrik 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ishte në shkrimoren e GjThF-së, ku u informua për të dhënat për lëndën dhe gjyqtarin e procedurës paraprake (I. B.), i ngarkuar me këtë rast. Takimi me gjyqtarin nuk u realizua për shkak se ai ndodhej në seancë gjyqësore.
11. Në po atë ditë, drejtoresha e QPS-së në Ferizaj e njoftoi përfaqësuesin e Avokatit të Popullit se i dyshuari për vrasje (V. A.) kanë qenë palë në QPS të Ferizajt, që nga data 4 korrik 2023, ku pas mosmarrëveshjeve që patën si çift, V. A. kërkoi që t'i mundësohej realizimi i kontaktit me fëmijën e tij. Ajo në vazhdim theksoi se Zyrtari i Shërbimit Social (ZShS), që menaxhoi rastin, e ndërpreu marrëdhënien e punës, për çka ajo caktoi një tjetër ZShS. Më pastaj përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kontaktoi me zyrtaren në fjalë, por ajo nuk ishte në gjendje të fliste për rastin atë ditë, për shkak të gjendjes shëndetësore të rënduar - tronditjes psikike që kishte përjetuar në ditën kur ndodhi vrasja.
12. Më 11 korrik 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit i dërgoi kërkesë nëpërmjet postës elektronike, mbikëqyrëses, në Zyrën për të Drejta të Njeriut dhe Diversitete në Policinë e Kosovës (ZDNjDPK), që të kërkonte nga zyrtarët përgjegjës të Stacionit Policor në Ferizaj, ta informonin me një raport kronologjik për zhvillimet e ngjarjeve nga këndvështrimi policor, si dhe ndërmarrjen e veprimeve nga kompetenca e tyre lidhur me ngjarjen e datës 12 prill 2024, në QPS të Ferizajt.
13. Më 12 korrik 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit i dërgoi kërkesë nëpërmjet postës elektronike prokurorit të PThF-së, i ngarkuar me rastin, ta njoftonte Institucionin e Avokatit të Popullit për ndërmarrjen e veprimeve nga ana e kësaj prokurorie, lidhur me rastin e datës 12 prill 2024.
14. Më 26 korrik 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit pranoi përgjigje me shkrim nga mbikëqyrësja e ZDNjDPPK-së, lidhur me kërkesën e parashtruar të datës 11 korrik 2024.
15. Më 6 gusht 2024, menaxheri i Zyrës Regjionale për Mbrojtjen e Viktimave (ZRMV) në Ferizaj e njoftoi përfaqësuesin e Avokatit të Popullit lidhur me rastin se në këtë zyrë nuk pati ndonjë denoncim ndaj V. A. nga ana e tashmë së ndjerës E. C., prindërve të saj, apo nga ndonjë burim tjetër, lidhur me ushtrimin e dhunës ndaj saj.
16. Më 14 gusht 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit pati një takim me prokurorin e PThF-DKR-së, i ngarkuar me rastin në fjalë, lidhur me të cilin ai njoftoi siç vijon: *"I pandehuri V.A. gjendet në paraburgim për veprën penale vrasje e rëndë që nga dt. 13 prill 2024. Më dt. 4 korrik 2024, kemi paraqitur kërkesën për vazhdimin e masës së paraburgimit PP/I. Nr. 47/2024 e cila është aprovuar nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake të GjThF dhe se të njëjtit i është vazhduar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej dt. 11 korrik 2024 - 9 shtator 2024."* Gjithashtu ai theksoi se janë kryer ekzaminimet mjeko-ligjore, ekzaminimi i armës, ndërkaq tani janë në pritje të ekzaminimit të telefonave nga Agjencia e Forenzikës.
17. Më 20 gusht 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, nga drejtoresha e QPS-së në Ferizaj pranoi përgjigjen se Raporti kronologjik i rastit do të dërgohej pasi menaxherja e rastit të kthehej nga pushimi vjetor. Rrjedhimisht, më 29 gusht 2024, drejtoresha e QPS-

së i dërgoi nëpërmjet postës elektronike përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, Njoftimin zyrtar dhe shkresat e tjera të lëndës që kanë të bëjnë me rastin.

18. Më 8 tetor 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit pati takim zyrtar në GjThF me gjyqtarin e procedurës paraprake, i cili e njoftoi atë për veprimet e ndërmarra deri më tani lidhur me procedurën paraprake, vazhdimin e paraburgimit si dhe ngritjen e aktakuzës nga ana e prokurorit të rastit, më datë 4 shtator 2024. Gjithashtu e njoftoi atë për adresimin e lëndës te gjyqtarja e GjThF-DKR-së, e cila tani e ka në procedim atë.
19. Më 25 tetor 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit pati një takim me gjyqtaren e rastit, e cila e njoftoi atë se më 8 tetor 2024 në GjThF-DKR u mbajt seanca për shqyrtim fillestar lidhur me aktakuzën e ngritur kundër të akuzuarit V. A., për shkak të veprës penale “*Vrasje e rëndë*”, të cilën vepër i akuzuari nuk e pranoi në këtë fazë të shqyrtimit dhe parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
20. Më 20 nëntor 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit realizoi një takim zyrtar në QPS me drejtoreshën e kësaj qendre, e cila e njoftoi atë se në muajin tetor 2024, Komuna e pajisi QPS-në me detektorë. Kompania e sigurimit e trajnoi punëtorin lidhur me menaxhimin dhe funksionalizimin e detektorit, i cili tani është i funksionalizuar dhe është plotësisht në funksion të sigurisë së QPS-së në Ferizaj.
21. Më 22 nëntor 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit i parashtroi kërkesë nëpërmjet postës elektronike, kryetarit të Asociacionit të QPS-ve, për t’u informuar lidhur me aspekte të sigurisë të QPS-ve në Kosovë, duke përfshirë edhe pajisjen me detektorë.
22. Më 11 dhjetor 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit iu drejtua këshilltarëve juridikë të IAP-së nëpërmjet e-mailit, me kërkesë për të marrë informacion nga drejtorët e QPS-ve: “*A janë të pajisur me detektorë, për detektimin e palëve, si masë e sigurisë?*” si dhe “*A kanë roje fizike të objektit?*”
23. Më 20 dhjetor 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit kërkoi informata nga drejtoresha e QPS-së me një raport kronologjik, lidhur me caktimin e kujdestarisë ndaj fëmijës, ushtrimin e kujdestarisë nga ana e saj, akomodimin e tij, gjendjen e përgjithshme të fëmijës në fjalë si dhe realizimin e marrëveshjes së datës 27 korrik 2024, lidhur me realizimin e kontaktit me gjyshen e tij, nga ana e nënës, deri në atë ditë.
24. Më 30 dhjetor 2024, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, lidhur me kërkesën e tij të datës 20 dhjetor 2024, pranoi nga drejtoresha e QPS-së përgjigjen me këtë përmbajtje: “[...] sipas marrëveshjes se bere mes kujdestares ligjore H.A. dhe gjyshes nga ana e nenës M.C. kjo marrëveshje te cilën po ashtu e keni te bashkëngjitur me date 29 gusht 2024,... gjithmonë ka shkuar ashtu siç edhe janë marr vesh palët e përfshira,... dhe nisur nga kjo ju njoftojmë se fëmija. është ne gjendje shume te mire shëndetësore dhe kontakti i tij me gjyshërit nga ana e nënës po vijon ne formën me te mire te mundshme për çka edhe vërehet lidhja emocionale e fëmijës me gjyshërit e tij.”
25. Më 10 janar 2025, në bazë të informatave që mori nga terreni, nga DShMS-të dhe QPS-të, Avokati i Popullit konstaton se: nga 38 prej tyre sa janë në Republikën e Kosovës, vetëm 2 (QPS e Prishtinës dhe ajo e Ferizajt) posedojnë sigurim fizik (roje) dhe detektorë për detektimin e armëve apo mjeteve të tjera të rrezikshme. Janë 21 QPS që nuk posedojnë detektorë, ndërsa 15 prej tyre, përveç detektorëve, nuk posedojnë madje as sigurim fizik (roje).

26. Më 14 shkurt 2025, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, nëpërmjet një parashtrëse kërkoi informata nga drejtoresha e QPS-së në Ferizaj, lidhur me zhvillimin e procedurës për pajtimin e bashkëshortëve, kohëzgjatjen e kësaj procedure, numrin e ZShS-ve, profilizimin e tyre, trajnimet që ndjekin për ngritje të kapaciteteve profesionale.
27. Më 21 shkurt 2025, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mori përgjigje lidhur me kërkesën e tij të datës 14 shkurt 2025, nga drejtoresha e QPS-së, e cila, mes të tjerash e njoftoi atë: “[...] Sa i përket marrëveshjes me shkrim për seancë të tentim pajtimin nuk është praktikuar asnjëherë në QPS (si dokument i veçantë për tentim Pajtim), por si dëshmi që kemi punuar për tentim pajtimin e tyre janë deklaratat e palëve me nr. protokolli 03-436 të datës 29.03.2024.” Ndërsa lidhur me stafin theksonte se në QPS aktualisht kanë vetëm pesë ZShS, të cilët nuk janë të profilizuar, ofrojnë shërbime sociale për kategori të ndryshme. Ajo shprehu nevojën e organizimit të trajnimeve profesionale.

### Instrumentet ligjore

28. Neni 21, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës përcaktojnë si në vijim: “Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë, Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”
29. Neni 22 i Kushtetutës përcakton: “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.” Kurse neni 23 përcakton: “Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.” Gjithashtu mbi bazën e këtij neni gjen zbatim të drejtpërdrejtë edhe Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (në tekstin e mëtejshëm: Konventa e Stambollit), e cila në nenin 5, paragrafi 2, përcakton: “Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera të nevojshme për të ushtruar masa paraprake për të parandaluar, hetuar, dënuar dhe siguruar kompensim për akte dhune të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, të cilat kryhen nga aktorë joshitetërorë.” Ndërsa në nenin 12, paragrafi 2, gjithashtu përcakton: “Palët marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të parandaluar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente nga çdo person fizik ose juridik.”<sup>5</sup>
30. Neni 25, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton si në vijim: “Secili individ gëzon të drejtën për jetën [...]” Ndërsa neni 26 përcakton: “Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj [...]”
31. Neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut<sup>6</sup> (4 nëntor 1950) (në tekstin e mëtejshëm: Konventa Evropiane) përcakton: “E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj [...]” Ndërsa neni 5, paragrafi 1, i kësaj Konvente përcakton: “Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj [...]”

<sup>5</sup>[https://shendetesia.gov.al/wpcontent/uploads/2018/03/Konventa\\_e\\_Keshillit\\_te\\_Europes\\_per\\_parandalimin\\_dhe\\_luftimin\\_e\\_dhunes\\_kunder\\_grave\\_dhe\\_dhunes\\_ne\\_familje.docx](https://shendetesia.gov.al/wpcontent/uploads/2018/03/Konventa_e_Keshillit_te_Europes_per_parandalimin_dhe_luftimin_e_dhunes_kunder_grave_dhe_dhunes_ne_familje.docx)

<sup>6</sup> [https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention\\_sqi](https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqi)

32. Kurse neni 53 të Kushtutës përcakton: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
33. Kushtetuta, akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve që t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë.
34. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: KDF), në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”* Tutje KDF-ja në nenin 19 përcakton: *“1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar. [...]”*
35. Neni 1, paragrafi 1, i Ligjit nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore<sup>7</sup> përcakton: *“Ky ligj ka për qëllim të parandalojë dhe trajtojë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, të mbrojë dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave si dhe të ndërtojë mekanizmat e nevojshëm për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të të gjitha formave të dhunës të rregulluara me këtë ligj.”*
36. Më tutje, neni 5 i po këtij ligji obligon institucionet shtetërore që t’i trajtojnë me prioritet të gjitha masat dhe aktivitetet për të parandaluar çdo efekt të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje. Kjo nënkupton edhe kujdesin e shtuar në ndërmarrjen e masave për vlerësimin e rrezikshmërisë, nga të gjitha autoritetit relevante, me qëllim të parandalimit të përsëritjes së dhunës, si në rastin konkret.
37. Ligji nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare<sup>8</sup> në nenin 3, paragrafi 1.12., QPS-në e përkufizon: *“[...] institucion social administrativ dhe profesional i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale.”*
38. Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës<sup>9</sup>, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/1-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës<sup>10</sup>, në paragrafin 1 të nenit 39 thekson: *“Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore) konsiderohet marrëdhënia faktike midis burrit dhe gruas që jetojnë në çifte, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe*

<sup>7</sup> [https://www.assemblyofkosovo.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr.08-L-185\\_9XfWg8YBCd.pd](https://www.assemblyofkosovo.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr.08-L-185_9XfWg8YBCd.pd)

<sup>8</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2447>

<sup>9</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

<sup>10</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18420>

vazhdueshmërie.” Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen thekson: “*Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore) është e barabartë me statusin martesor nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare reciproke, dhe të drejtat pasurore ashtu siç është specifikuar në këtë ligj.*”

39. Ndërsa në nenin 125, paragrafi 1, të të njëjtit ligj theksohet: “*Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.*” Ndërsa sipas paragrafit 2 të po këtij neni theksohet: “*Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t’i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë.*”
40. Gjithashtu nenin 83, paragrafi 1, i ligjit në fjalë parasheh shprehimisht: “*Procedura e pajtimit pranë Organit të Kujdestarisë nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj, por mund të vazhdohet, nëse bashkëshortët pajtohen që të vazhdojnë një procedurë të këtillë pas përfundimit të këtij afati.*” Ndërsa në paragrafin 2 thuhet: “*Organi i Kujdestarisë është i detyruar pa vonesë të dërgojë në gjykatë raportin më shkrim lidhur me rezultatin e procedurës së pajtimit.*”
41. Ndërsa në nenin 156, paragrafi 1, të ligjit në fjalë theksohet: “*Fëmijë pa kujdes prindëror konsiderohet fëmija prindërit e të cilit nuk janë gjallë, prindërit e të cilit janë të panjohur ose janë zhdukur.*” Ndërkaq në paragrafin 2 theksohet: “*Fëmijë pa kujdesin prindëror është edhe fëmija prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore ose kujdesin prindëror.*”
42. Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në nenin 28, paragrafi 1, pika 1, parasheh: “*Mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindëror realizohet përmes formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, siç janë: kujdestaria...*” Kurse në paragrafin 2 të këtij neni thuhet: “*Institucionet sigurojnë forma të mbrojtjes për fëmijët pa përkujdesje prindërore, bazuar në legjislacionin në fuqi.*”
43. Ligji nr.03/L-212 i Punës<sup>11</sup>, në nenin 42, paragrafi 1, thekson: “*I punësuari ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin për siguri në punë .mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës.*” Ndërsa në paragrafin 2 theksohet: “*I Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.*”
44. Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë,<sup>12</sup> në nenin 1, thekson: “*Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë.*” Ndërsa në paragrafin 2 thekson: “*Ky ligj përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimit të të punësuarve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve.*”

## Analiza ligjore

45. Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një përgjigje efektive në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës

<sup>11</sup> <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/ligji-nr-03-l-212-ligji-i-punes-pdf/>

<sup>12</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>

në familje në Republikën e Kosovë, sidomos e drejta për jetë, e cila klasifikohet si e drejtë absolute. Edhe përkundër faktit se Republika e Kosovës ka bërë hapa mjaft serioz në krijimin e mekanizmave reagues ndaj rasteve të dhunës në familje, ka ende aspekte që kërkojnë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e së drejtës në jetë, duke përfshirë ndërmarrjen e masave preventive për krijimin e ambienteve të sigurt të së drejtës për jetë, për të eliminuar çfarëdo mundësie të paraqitjes së situatës sikurse më 12 prill 2024, ku në QPS në Ferizaj, gjatë procedimit zyrtar të rastit të tij, V. A. privoi nga jeta me disa të shtëna nga revolja ish-bashkëshorten e tij, plagosi rëndë vëllain e saj të mitur, si dhe kërcënoi edhe ZShS-në, e cila po procedonte me rastin. Viktimat e dhunës në familje vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme, sidomos nga mosfunksionimi i autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e kësaj dukurie shqetësuese e të cilat në shumë raste po përfundojnë me fatalitet.

46. Kushtetuta, akti më i lartë juridik, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e të tjerëve, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë.
47. Kushtetuta, në nenin 25, paragrafi 1, përcakton: "*Secili individ gëzon të drejtën për jetën.*" Nga ky paragraf shihet qartë se e drejta për respektimin e jetës së qytetarit gjendet në qendër të sistemit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe si e tillë është e drejtë absolute e njeriut, e cila nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë, si dhe nuk lejohet shmangia nga kjo e drejtë. Avokati i Popullit vëren se Kushtetuta definon qartë se secili person ka të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që, përveç të tjerash, kur bëhet fjalë për të drejtën e integritetit personal, për të drejtën shëndetësore dhe për të drejtën për jetë, shteti ka detyrim pozitiv t'i ndërmarrë të gjitha masat për ta mbrojtur pacenueshmërinë e integritetit fizik dhe shëndetësor të personave, veçanërisht kur rrezikohet integriteti dhe jeta e njeriut. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në Aktgjykimin KI. 41/12<sup>13</sup> ka gjetur se ka shkelje të së drejtës për jetë në rastet kur organet kompetente të shtetit nuk u ofronin mbrojtje të mjaftueshme qytetarëve të ekspozuar dhunës në familje dhe kur për këtë e kërkonin rrethanat e rastit. Gjykata Kushtetuese theksoi se e drejta për jetë është e drejta më e rëndësishme prej të gjitha të drejtave njerëzore, nga e cila burojnë të gjitha të drejtat e tjera dhe sqaroi se ekzistojnë detyrime pozitive për organet e pushtetit që të ndërmarrin masa parandaluese dhe operative për ta mbrojtur jetën e të gjithë atyre që i janë ekspozuar rrezikut.
48. Konventa e Stambollit, si një instrument i rëndësishëm në këtë fushë, që ka për qëllim parandalimin e dhunës ndaj grave, mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen penale të kryerësve të dhunës, në paragrafin 1 të nenit 5 [Detyrimet e shtetit dhe masat paraprake] përcakton se autoritetet shtetërore, përfshirë këtu edhe shërbimet sociale, kanë përgjegjësi për të parandaluar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar aktet e dhunës ndaj grave dhe, në paragrafin 5 të nenit 18 [Detyrimet e përgjithshme], mes të tjerash, thekson edhe detyrimin për t'i marrë masat e nevojshme për t'i mbrojtur ato.

---

<sup>13</sup> Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI 41/12, parashtrues Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

49. Përveç luftimit të dhunës ndaj gruas, që është detyrë imediate që të arrihet një barazi me e madhe midis grave dhe burrave, kërkohet ndërmarrja e masave të përgjithshme, sepse vetëm barazia e vërtetë midis grave dhe burrave me të njëjta të drejta dhe përgjegjësi si dhe vlerësimi i kontributit të tyre në mënyrë të barabartë, mund të eliminojë me të vërtetë pabarazinë dhe dhunën ndaj grave. Në këtë drejtim mund të konstatojmë se Kosovës i duhet edhe shumë për të bërë, ndërsa rasti që jemi duke e trajtuar paraqet dështimin e autoriteteve dhe institucioneve tona, ku përveç humbjes së një jete si dhe rrezikimit të jetëve të tjera, u godit rëndë nga pasojat e atij veprimi fëmija njëvjeçar. E në këtë drejtim lidhur me sanimin e pasojave që kanë të bëjnë me fëmijën, kujdesin për te, mirërritjen e tij etj., Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: KDF) jep zgjidhje adekuatë, ku në nenin 3, paragrafi 1, përcakton se interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë mbizotërues në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, pavarësisht a merren nga institucionet publike apo private, gjykatat apo autoritetet e tjera, si ato administrative. Me këtë zgjidhje është i familjarizuar edhe Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, të cilin lidhur me rastin konkret dhe situatën e fëmijës e ka aplikuar saktësisht QPS-ja.
50. Neni 2 i Konventës Evropiane paraqet detyrimet e përgjithshme të shtetit për ta mbrojtur të drejtën për jetë dhe përfshin aspektet pozitive dhe negative: a) detyrimin pozitiv për ta mbrojtur jetën; dhe b) detyrimin negativ që të përmbahet nga marrja e paligjshme e jetës. Obligimi pozitiv imponon detyrime të parandalimit dhe hetimit. Detyrimet e parandalimit (shih rastin e Gjykatës Evropiane: *Osmani kundër Britanisë së Madhe, i datës 28 shkurt 1998*) i obligojnë qeveritë e shteteve që t'i pengojnë dhe t'i luftojnë veprat penale. Prandaj, nëse vërtetohet se qeveritë kishin njohuri, ose do të duhej të kishin njohuri në kohën e ekzistimit të rrezikut real dhe të drejtpërdrejtë për jetën e një personi të identifikuar nga veprat penale të palëve të treta dhe nëse nuk kanë ndërmarrë masa të duhura në kuadër të kompetencave të veta, të cilat, sipas një vlerësimi të arsyeshëm, mund të priteshin, në mënyrë që të shmangej rreziku për jetë, të njëjtat duhet të jenë përgjegjëse për moszbatim të detyrimeve pozitive.

### **Konstatimet e Avokatit të Popullit**

51. Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një përgjigje efektive në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Republikën e Kosovë, sidomos e drejta për jetë, e cila klasifikohet si e drejtë absolute. Edhe përkundër faktit se Republika e Kosovës ka bërë hapa mjaft serioz në krijimin e mekanizmave reagues ndaj rasteve të dhunës në familje, ka ende aspekte që kërkojnë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e së drejtës në jetë, duke përfshirë ndërmarrjen e masave preventive për krijimin e ambienteve të sigurta lidhur me të, për të eliminuar çfarëdo mundësie të paraqitjes së situatës sikurse më 12 prill 2024, ku në QPS në Ferizaj (QPS), viktimë ishte një grua, e cila ishte duke marrë shërbimin nga kjo QPS. Viktimat e dhunës në familje vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme, sidomos nga mosfunksionimi i autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e kësaj dukurie.
52. Avokati i Popullit vëren se QPS-ja në Ferizaj, duke filluar nga data 4 korrik 2023, e ka trajtuar kërkesën e V. A., e cila lëndë është kategorizuar si “Kontakt me fëmijën”. Palët u pajtuan mes vete që kontakti i prindit të realizohet në QPS, çdo të premte të dytë dhe të katërt të muajit, në orën 13:30.

53. Lidhur me marrëveshjen e arritur (gojore), midis V.A. dhe E. C. për realizimin e kontaktit me fëmijën, Avokati i Popullit konstaton se drejtoria e QPS-së në Ferizaj nuk përpiloi fare marrëveshje me shkrim, apo ndonjë procesverbal, çka paraqet keqmenaxhim të rastit në kuptimin profesional. Në Njoftimin zyrtar të QPS-së të datës 29 gusht 2024 nuk specifikohet të ketë pasur marrëveshje me shkrim, e gjithashtu faktohet vetëm koha e sjelljes së fëmijës në orën 13:30, ndërsa nuk precizohet fare kohëzgjatja e takimit.
54. Gjithashtu nga Njoftimi zyrtar i datës 29 gusht 2024, dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit, vërehet se më datën 21 korrik 2023, në zyrën e QPS-së në Ferizaj, në prani të ZShS-së u mbajt një seancë lidhur me sanimin e raporteve familjare në bazë të kërkesës së V. A., të cilën E. C. fillimisht e kundërshtoi, por pastaj u pajtua për mbajtjen e saj. Me këtë rast Avokati i Popullit vëren se lidhur me këtë seancë, QPS-ja, përkatësisht ZShS-ja, nuk hartoi asnjë procesverbal që do ta pasqyronte rrjedhën e këtij takimi, ku do të mund të kuptohej saktë vullneti i E. C. lidhur me rikthimin e saj në martesë apo jo. Keqmenaxhimin e rastit në fjalë e vërteton për më tej procesverbali i datës 29 mars 2024, ku vërejmë se E. C. ka deklaruar mes të tjerash se ajo përfundimisht nuk do të ketë lidhje me ish-bashkëshortin, ndërsa për sa i përket djalit, kontakti me të ka dashur që të realizohet përmes QPS-së, e cila do ta mbikëqyr atë.
55. Avokati i Popullit vëren se në nenin 83, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës<sup>14</sup> (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës) thekson: “*Procedura e pajtimit pranë Organit të Kujdestarisë nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj, por mund të vazhdohet, nëse bashkëshortët pajtohen që të vazhdojnë një procedurë të këtillë pas përfundimit të këtij afati.*” Nisur nga përgjigjja e QPS-së, e datës 21 shkurt 2025, Avokati i Popullit konstaton se në rastin në fjalë nuk u veprua në përputhje me nenin 83 të këtij ligji. Nga përgjigjja lihet për t’u kuptuar se procedura e pajtimit ka zgjatur më tepër se tre muaj dhe se nuk ka pasur marrëveshje me shkrim midis bashkëshortëve për vazhdimin e saj, çka dëshmon arbitraritetin dhe joprofesionalizmin evident të QPS-së për rastin në fjalë. Më konkretisht lidhur me këtë, shih pikat 26 dhe 27 të këtij raporti.
56. Avokati i Popullit thekson se në bazë të njoftimeve që pranoi nga PThF-ja dhe GjThF-ja, V. A. gjendet në paraburgim dhe më 8 tetor 2024 në GjThF-DKR u mbajt seanca për shqyrtim fillestar lidhur me aktakuzën e ngritur kundër tij, për shkak të veprës penale “*Vrasje e rëndë*”, nga neni 173, par. 1., nënpar. 1.3 dhe 1.5, të KPRK-së, të cilën vepër i akuzuari nuk e pranoi në këtë fazë të shqyrtimit dhe e ankimoi në Gjykatën e Apelit.
57. Avokati i Popullit rikujton se Ligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në nenin 28, paragrafi 1, pika 1, parasheh që mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindëror realizohet edhe nëpërmjet kujdestarisë, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni thekson se kjo mbrojtje bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi. Me këtë rast Avokati i Popullit vlerëson ndërmarrjen e veprimeve efikase dhe me kohë të QPS-së lidhur me strehimin familjar të fëmijës, më datë 25 prill 2024, duke ia caktuar atij kujdestar ligjor, gjyshen e tij nga ana e babait, si personin më të përshtatshëm.
58. Avokati i Popullit vëren se QPS-ja në Ferizaj, më 24 korrik 2024, përpiloi marrëveshjen mes palëve, sipas së cilës, kujdestarja ligjore për çdo të premtë të parë dhe të tretë të muajit, duke filluar nga ora 10:00, në zyre të QPS-së do ta dorëzojë fëmijën te gjyshja nga

---

<sup>14</sup><https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

ana e nënës, e cila do ta kthejë atë të hënën në orën 10:00 në QPS, për dorëzim te kujdestarja ligjore. Avokati i Popullit, nisur nga informacioni dhe dokumentacioni provues, vlerëson punën e QPS-së për faktin se marrëveshja në fjalë është duke u realizuar me përpikëri, veprime këto që përmbushin kërkesat për mbrojtjen e fëmijës, siç e precizon Ligji nr.06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, në nenin 5, paragrafi 1.

59. Avokati i Popullit thekson se një nga pengesat e mosfunksionimit efikas të QPS-ve janë kushtet e punës së ZShS-ve në këto qendra. Në këtë drejtim, duke vërejtur këtë dukuri, Avokati i Popullit shqetësimet e tij i ka ngritur në Raportin me rekomandime ex officio nr. 59/2019<sup>15</sup>, ku ka trajtuar çështjet e legjislacionit, strukturimit, kompetencave të QPS-ve etj. Në këtë aspekt, mes të tjerash, raporti në fjalë në pikën 48 thekson: *“QPS-të ofrojnë mbi 50 lloje të shërbimeve sociale profesionale. Zyrtarët e shërbimeve sociale nuk i kanë të ndara referatet, por janë të obliguar që të merren me të gjitha kategoritë e rasteve dhe të gjitha llojet e shërbimeve sociale profesionale. Natyra e punës është e ndryshme për secilin rast dhe është e pamundshme që një zyrtar i shërbimeve sociale t’i posedojë shkathtësitë e njëjta për trajtimin e secilës kategori.”* Ndërsa pika 49 e këtij raporti thekson: *“Trajnime profesionale të cilat ofrohen për QPS-të. sidomos për stafin i cili merret me punë të drejtpërdrejtë, janë shumë të pakta dhe jo të ndonjë niveli adekuat me trajnerë profesionistë...”*
60. Avokati i Popullit, bazuar në informacionet që posedon, thekson se QPS-të në drejtim të klasifikimit të referateve për ZShS-të, si dhe në drejtim të trajnimeve profesionale, nuk i bënë hapat e nevojshëm, që do të ndikonin në rritjen e efikasitetit të punës lidhur me trajtimin e rasteve, çka do të rezultonte me zgjidhjen efikase të tyre.
61. Bazuar në përgjigjen e QPS-së në Ferizaj të datës 21 shkurt 2025, lidhur me kapacitetet e kuadrove të saj, Avokati i Popullit vlerëson se është brengosëse sa i përket kapacitetit. Sipas shkresës në fjalë, QPS-ja tani për tani ka vetëm pesë ZShS (dy para pensionit), që ofrojnë shërbime sociale për grupe të ndryshme të qytetarëve. Këta zyrtarë nuk janë të profilizuar si dhe nuk janë të trajnuar mjaftueshëm, çka sinjalizon një gjendje të paqëndrueshme.
62. Gjithashtu Avokati i Popullit thekson se QPS-të do të duhej t’i ndërmerrnin edhe veprimet të nevojshme në drejtim të përmirësimit dhe sigurimit të mbrojtjes së jetës dhe të shëndetit të punonjësve, në pajtim me nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë,<sup>16</sup> si dhe të paragrafit 2 të nenit 42 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës.<sup>17</sup>
63. Avokati i Popullit konstaton se gjendja në të cilën funksionojnë ZShS-të në QPS është plotësisht e paqëndrueshme jo vetëm për shkak të vëllimit të punës, joprofilizimit, siç thamë më lart, por edhe si pasojë e rrezikimit të mundshëm të drejtpërdrejtë të jetës në vendet e tyre të punës. Avokati i Popullit, nisur nga të gjeturat e gjertanishme, thekson se jeta e ZShS-së, e cila ka menaxhuar me rastin në fjalë, ka qenë e rrezikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, më 12 prill 2024, kur u vra E. C., në ambientet e QPS-së, nga ish-bashkëshorti i saj V. A. Për pasojë tani ajo është duke marrë trajtim mjekësor.
64. Nga intervistat që Avokati i Popullit zhvilloi me drejtorët e DShMS-ve dhe të QPS-ve, rezulton se përgjithësisht gjendja në QPS është larg standardeve më elementare, që do të

<sup>15</sup> Shih Raporti me rekomandime ex officio nr.59/2019, datë 17 dhjetor 2019.

<sup>16</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8689>

<sup>17</sup> <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/ligji-nr-03-l-212-ligji-i-punes-pdf/>

bënin që ato ta realizojnë funksionin e tyre për çka janë themeluar - ofrimin e shërbimeve sociale.

65. Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e tij të thellë, sepse nga të gjitha QPS-të, prej rastit tragjik të datës 12 prill 2024, ku u vra E. C. dhe u plagos vëllai i saj i mitur, si dhe u kërcënua në mënyrë të drejtpërdrejtë ZShS-ja, e cila po ofronte shërbime sociale lidhur me rastin, vetëm QPS-ja e Prishtinës posedonte edhe më herët detektorë për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme. QPS-ja në Ferizaj është pajisur me detektorë vetëm pas rastit tragjik, ndërsa 36 QPS anembanë Kosovës jo vetëm që vazhdojnë të jenë të pa pajisura me detektorë, por një pjesë e mirë e tyre madje nuk posedojnë as roje të sigurimit fizik.

66. Nga intervistat që përfaqësuesit e Avokatit të Popullit i zhvilluan me drejtorët e DShMS-ve dhe të QPS-ve, komunikimet e tjera dhe hulumtimi në përgjithësi rezulton se gjendja në QPS-ve është larg standardeve më elementare për ta përmbushur funksionin e tyre për çka janë themeluar - ofrimin e shërbimeve sociale. Prandaj Avokati i Popullit, duke u nisur nga këto, i

## **REKOMANDON**

### **Komunës së Ferizajt:**

- *Të plotësohen vendet e nevojshme të punës me zyrtarë për shërbime sociale në QPS;*
- *Të organizohen trajnime profesionale për zyrtarët e shërbimeve sociale.*

### **Komunës së Podujevës:**

- *Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.*

### **Komunës së Obiliqit:**

- *Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.*

### **Komunës së Drenasit:**

- *Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.*

### **Komunës së Lipjanit:**

- *Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.*

### **Komunës së Graçanicës:**

- *Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.*

### **Komunës së Kaçanikut:**

- *Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.*

### **Komunës së Gjilanit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Kamenicës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Klllokotit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Ranillukut:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Parteshit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Mitrovicës Jugore:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Skenderajt:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Vushtrrisë:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Prizrenit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Gjakovës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Pejës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Mitrovicës Veriore:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Leposaviqit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Zubin Potokut:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Zveçanit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Fushë Kosovës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Hanit të Elezit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Shtimes:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Vitisë:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Novobërdës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Suharekës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Mamushës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Dragashit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Rahovecit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Malishevës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, të pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Istogut:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Junikut:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Klinës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Deçanit:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

**Komunës së Shtërpçës:**

- Brenda një afati sa më të shkurtër, ta pajisë QPS-në me roje fizike dhe me detektor për detektimin e armëve apo të mjeteve të tjera të rrezikshme.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/I-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

